



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**MISIONI NË KOSOVË**

**Departamenti për Monitorim**

**Çështjet e furnizimit më ujë në Kosovë**

**Korrik 2008**

## PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje ekzekutive .....	3
2. Kthim në retrospektivë: mungesa të mëdha të ujit gjatë verës së vitit 2007.....	4
3. Informata të reja: gatishmëria e komunave në pranverën e vitit 2008.....	4
3.1 Rezervuarët e ujit në Kosovë dhe menaxhimi i tyre, gjendja në maj të vitit 2008 .....	4
3.2 Niveli i vetëdijes në komuna dhe masat e ndërmarra .....	5
4. Korniza ligjore .....	6
4.1 Kompetencat për menaxhimin e ujit .....	6
4.2 E ardhmja e menaxhimit të furnizimit me ujë në Kosovë.....	7
5. Vlerësimi i rrezikut .....	7
5.1 Kërkesa më e lartë.....	7
5.2 Faktorët e mjedisit.....	8
5.3 Kufizimet financiare .....	9
5.4 Rreziku i reaksionit zinxhiror .....	9
5.5 Rreziqet politike.....	9
6. Rëndësia e bashkëpunimit rajonal dhe ndërshtetëror.....	10
7. Përfundimet dhe rekomandimet.....	11

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Ekipet komunale të Misionit të OSBE-së (OSBE), verën e vitit 2007 raportuan mbi çështjet e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve në lidhje me mungesat e mëdha të ujit në tërë Kosovën, duke ngritur shqetësime serioze mbi furnizimin dhe qasjen në ujë për të gjitha komunitetet. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes ndaj këtij problemi, OSBE-ja ka organizuar punëtori, ka shpërndarë fletëpalosje mbi kursimin e ujit, si dhe është angazhuar në aktivitete tjera, shpeshherë së bashku me përfaqësues të KFOR-it dhe të UNMIK-ut.

Ndonëse gjendja e furnizimit me ujë gjatë verës së vitit 2008 mund të mos jetë aq problematike sa ajo e vitit 2007, ajo ende nuk është aspak e kënaqshme dhe me gjasë do të rezultojë në një situatë të pasigurt qysh në vitin e ardhshëm. Duke pasur parasysh shumë rreziqe të ndryshme, siç janë dimrat e thatë, rreziqet për shëndetin e që lidhen me kontaminimin e burimeve të ujërave, si dhe gjendjen e keqe të shumicës së infrastrukturës së ujit, gjendja në Kosovë duhet të trajtohet urgjentisht.

Megjithatë, mekanizmat efektivë ose planifikimi afatgjatë nuk është përcaktuar në nivel komunal ose atë rajonal. Jo vetëm që një gjë e tillë përsëri mund të shpie në shkelje të të drejtave të njeriut sa i përket qasjes në ujë, por edhe në probleme të nivelit politik, pasi që në masë të madhe do të mund të kontestoheshin masat për kufizimin e qasjes në ujë. Ndonëse OSBE-ja nuk ka mundur të identifikojë skema sa i përket diskriminimit në baza etnike, kjo çështje mund të bëhet akute në rast të mungesave të ardhshme të ujit.

Po ashtu, OSBE-ja ka vërejtur se komunat e Kosovës nuk janë të përgatitura sa duhet për të trajtuar mungesat akute të ujit. Në veçanti, zonat rurale nuk kanë qasje në ujë të rrjedhshëm por janë në varësi të puseve dhe burimeve lokale me cilësi të dyshimtë të ujit. Komunat duket se nuk janë të vetëdijshme sa duhet mbi përgjegjësitë e tyre, si dhe mbi rreziqet me të cilat mund të përballen në të ardhmen. Për më tepër, sa i përket zbatimit të projekteve të domosdoshme për ujë, shumica e komunave të Kosovës varen shumë nga përkrahja e KFOR-it dhe e donatorëve ndërkombëtarë.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, OSBE-ja ka publikuar këtë raport me qëllim të ngritjes së vetëdijes së autoriteteve përgjegjëse në Kosovë dhe për fillimin e një diskutimi konstruktiv mbi mënyrën e trajtimit të problemeve të mungesave të ujit në periudhë afatgjate dhe në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme. Në raport po ashtu shkurtimisht përmenden bashkëpunimi i mundshëm rajonal sa i përket menaxhimit të resurseve ujore dhe perspektivat e menaxhimit të ujit pas mbylljes së Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e cila ishte përgjegjëse deri në qershor të vitit 2008.

Ky raport së pari ofron informata të reja mbi gjendjen gjatë pranverës - verës 2008 dhe ofron informata mbi këndvështrimin e autoriteteve komunale dhe aftësitë e tyre për t'u përballur me mungesat e mundshme të ujit në të ardhmen. Pastaj në raport shpjegohet roli i kompanive rajonale të ujit, paraqet vlerësimin të rrezikut dhe ofron rekomandime sesi aktorë ndërkombëtarë dhe vendorë mund të ngrisin vetëdijen ndaj problemeve të përsëritura të furnizimit me ujë në Kosovë. Në disa kapituj, raporti në mënyrë specifike përqendrohet në Prishtinë/Priština, meqë ky rajon përballlet me sfida të veçanta për shkak të përqendrimit të popullatës, rritjes së vazhdueshme të popullatës dhe fluksit të madh të ndërtimeve.

Përmbledhtazi, konstatimet më të rëndësishme siç janë rritja gjithnjë e më e madhe e kërkesës për ujë, e kombinuar me furnizim të ulët dhe të pamjaftueshëm me ujë, mungesa e trajtimit të ujërave të papërdorshme dhe pasojat afatmesme të kësaj në ujërat nëntokësore, zhvillimet e paqarta në administrimin dhe mbikëqyrjen e kompanive rajonale të ujit, mosrregullimi i shpërndarjes së kompetencave në lidhje me ujin, infrastruktura e vjetruar e ujit dhe sjellja alarmuese sa i përket pagesës së ujit, lënë të nënkuptohet se në vitin 2009 do të ketë një gjendje të paqëndrueshme dhe të pasigurt në Kosovë dhe kjo do të jetë një kërcënim më serioz ndaj furnizimit të mjaftueshëm me ujë në vjetët në vijim.

## 2. Kthim në retrospektivë: mungesa të mëdha të ujit gjatë verës së vitit 2007

Para vitit 2005, ndërprerjet e ujit në Kosovë kanë qenë kryesisht të natyrës teknike. Pas ndërtimit të stacioneve të reja të pompimit, gjendja e furnizimit me ujë kishte shënuar përmirësim të dukshëm gjatë vitit 2005 dhe në fillim të vitit 2006 kur Prishtina/Priština kryesisht furnizohej me ujë 24 orë në ditë. Megjithatë, për shkak të periudhave me mot shumë të thatë gjatë dimrit 2006/2007<sup>1</sup>, sërish pati nevojë për ndërprerje të furnizimi me ujë. Gjendja në furnizimin me ujë shënoi përkeqësim të dukshëm gjatë verës së vitit 2007, ku u raportuan mungesa të mëdha në tërë Kosovën, që preknin konsumin individual, bujqësinë dhe industrinë. Si rrjedhojë, autoritetet dolën me masa të caktuara emergjente që synonin të kufizonin shfrytëzimet e ujit. Fshatrave u është ndërprerë furnizimi me ujë me orë ose me ditë të tëra. Në korrik të vitit 2007, kompania lokale e ujësjellësit në Podujevë/Podujevo filloi me ndalesa prej dhjetë orësh në ditë në qytet pas zvogëlimit dramatik të nivelit të liqenit të Batllavës. Komuna e Prishtinës/Priština nxori një rregullore e cila ndalonte përdorimin e ujit për larjen e rrugëve, veturave ose ujitjen e kopshteve në mars të vitit 2007. Megjithatë, udhëzimet përkatëse nuk janë zbatuar në mënyrë konsekuente. Përdorimi i pakujdesshëm i ujit në Kosovë, p.sh., lagia e trotuareve dhe e rrugëve, si dhe larja e veturave e rëndonte edhe më shumë situatën veçse problematike të furnizimit me ujë.

Ndonëse komunat theksojnë se ato ofrojnë shërbime në baza jodiskriminuese, komunitetet joshqiptare në disa rajone ishin të mendimit se ndërprerjet e ujit gjatë viteve të fundit në vendbanimet e tyre ishin të pabarabarta dhe të motivuara etnikisht. Megjithatë, OSBE-ja nuk është dijeni të ndonjë incidenti të rëndësishëm të diskriminimit etnik në Kosovë sa i përket furnizimit me ujë. Përkundrazi, ekipet komunale të OSBE-së kanë raportuar se autoritetet komunale ishin posaçërisht përkrahëse ndaj grupeve të cenushme.<sup>2</sup>

Ekipet komunale të OSBE-së janë angazhuar në ngritjen e vetëdijes mbi problemet e ujit në nivel komunal në vitin 2007. Për shembull, në gusht të vitit 2007 Ekipi komunal i Prishtinës/Priština ka organizuar punëtori mbi kursimin e ujit me përfaqësues të shoqërisë civile, komuna dhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor. Rekomandimet kryesore përfshinin nisjen e një fushate mediale mbi konsumin e përgjegjshëm të ujit, kërkesën për zbatim të rreptë të ligjit kundër kyçejeve ilegale dhe mospagimit të faturave të ujit, si dhe një administratë të përgjegjshme dhe llogaridhënëse gjatë mirëmbajtjes së sistemit efektiv të ujit.<sup>3</sup>

## 3. Informata të reja: gatishmëria e komunave në pranverën e vitit 2008

### 3.1 Rezervuarët e ujit në Kosovë dhe menaxhimi i tyre, gjendja në maj të vitit 2008

Pesë rezervuarët kryesorë të ujit në Kosovë janë Gazivoda, Batllava, Badovci, Përlepnica dhe Radoniqi.

<sup>1</sup> Njësia e ujit pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit përmend dy periudha në dekadat e fundit si jashtëzakonisht të thata: Dimri 1966/67 dhe 2006/07.

<sup>2</sup> Për shembull, në Malishevë/Mališevo Rahovec/Orahovac, komunat kanë siguruar furnizim me ujë pa pagesë për familjet që jetojnë me asistencë sociale ose kanë ofruar lehtësime të tjera shtesë për komunitetet joshqiptare.

<sup>3</sup> Po ashtu, në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić, Viti/Vitina dhe Pejë/Peć, ekipet komunale të OSBE-së ndërmorën iniciativa për ngritjen kësaj çështjeje me autoritetet komunale dhe kompanitë e ujit dhe kanë organizuar takime me bartës relevantë. Pastaj disa komuna ndërmorën masa të menjëhershme përmirësuese për të zbutur gjendjen së bashku me kompaninë e ujësjellësit apo me ndihmën e KFOR-it.

Ndonëse në liqenin e Batllavës, që siguron rreth 70% të furnizimit me ujë për Prishtinën/Priştina, niveli i ujit në maj të vitit 2008 ishte më i lartë sesa në vitin 2007. Ndërsa rezervuarët e tjerë të ujit kishin më pak ujë sesa vitin e kaluar. Gjendja e përgjithshme nuk është alarmante në periudhën afatshkurtër; megjithatë, mbetet të shihet se si kjo gjendje do të zhvillohet gjatë muajve në vijim.

Në Kosovë ekzistojnë gjatë kompani rajonale të ujësjellësit të cilat janë në pronësi publike.<sup>4</sup> Këto kompani zakonisht mbulojnë komuna të ndryshme. Sipas një përfaqësuesi të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit<sup>5</sup>, kompanitë rajonale të ujit në Kosovë, të cilat janë të regjistruara si shoqëri të korporatizuara aksionare, aktualisht funksionojnë mirë. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të ndryshimeve të Agjencisë në menaxhmentin e lartë, duke u përqendruar vetëm në elementet profesionale. Përveç tjerash, shumica e kompanive rajonale të ujit janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet operative pa patur nevojë për mbështetje financiare.<sup>6</sup>

Në anën tjetër, në Leposavić/Leposaviq dhe Shtërpçë/Štrpce, çështjet e ujit menaxhohen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujit dhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor përkatësisht (përmes zyrave të vendosura në këto komuna). Në pjesën veriore të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica, çështjet e ujit menaxhohen nga kompanitë që janë pjesë e strukturave paralele serbe.<sup>7</sup> Sipas një studimi të OSBE-së të prillit 2008, komunat pretendojnë të jenë përgjithësisht të kënaqura me bashkëpunimin ndërmjet nivelit lokal dhe rajonal, sa i përket çështjeve të ujit.<sup>8</sup>

Udhëzimi i nivelit qendror deri më tani u është dhënë pesë komunave, përfshirë udhëzimet e përgjithshme mbi cilësinë e ujit dhe njoftimi mbi shfrytëzimin efikas të ujit, si dhe mbi vendimet për përdorimin e kufizuar të ujit dhe gjobat në rast të keqpërdorimit të ujit.<sup>9</sup> Më shumë se gjysma e komunave deklarojnë se nuk kanë fare kontakt me nivelin qendror. Me përjashtim të komunës së Podujevës/Podujevo, e cila e ka marrë strategjinë e ujit gjatë verës së vitit 2007, asnjë komunë nuk ka raportuar se ka marrë një strategji të tillë nga niveli qendror. Vetëm tetë komuna ndjehen përgjegjëse për monitorimin e nivelit të pellgut lokal të ujit, që kryesisht bëhet çdo javë apo çdo dy javë. Të gjitha komunat e tjera besojnë se kjo hyn nën përgjegjësinë e kompanive rajonale të ujit.

### 3.2 Niveli i vetëdijes në komuna dhe masat e ndërmarra

Rreth 80% e të gjitha komunave të Kosovës kanë vuajtur nga mungesat e ujit në pesë vitet e fundit, në 70% të të cilave gjendja ishte rënduar në vitet e fundit.<sup>10</sup> Shumica e komunave presin mungesa të ujit gjatë verës së vitit 2008 për shkak të thatësirave dhe arsyeve tjera.<sup>11</sup> Mungesat e ujit në zonat urbane shpeshherë lidhen me mungesën e rrymës elektrike. Pothuajse të gjitha komunat mendojnë se gjendja e tyre individuale është më e mirë krahasuar me komunat dhe rajonet e tjera.<sup>12</sup> Për më tepër, të gjitha komunat e prekura pretendojnë të jenë të vetëdijshme mbi gjendjen e tyre sa u përket

<sup>4</sup> Kompania rajonale e ujësjellësit Prishtinë/Priştina, “Hidroregjioni Jugor” në Prizren, “Hidrodrini” në Pejë/Peć, Kompania rajonale e ujësjellësit në Mitrovicë/Mitrovica, “Hidrosistemi Radoniqi” në Gjakovë/Đakovica, dhe “Hidromorava” në Gjiilan/Gnjilane.

<sup>5</sup> Takimi me një përfaqësues të sektorit të ujit pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit më 29 prill 2008.

<sup>6</sup> Po aty. Sipas përfaqësuesit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, vetëm një kompani, Kompania rajonale e ujësjellësit në Mitrovicë/Mitrovica, ka nevojë për mbështetje financiare.

<sup>7</sup> Për shembull, kompania e furnizimit me ujë *Ibar*.

<sup>8</sup> Megjithatë, Kačaniku/Kaçanik, Kamenica/Kamenica, Vitia/Vitina, Fushë Kosova/Kosovo Polje, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Hani Elezit/Đeneral Janković, Gjiilani/Gnjilane dhe Novobërda/Novo Brdo kanë përshkruar marrëdhëniet me nivelin rajonal si jo të mira ose joekzistuese.

<sup>9</sup> Duhet të përmendet se vetëm nëntë komuna i kanë drejtuar kërkesat në nivelin qendror.

<sup>10</sup> Në disa raste ekstreme, sikurse në Zvečan/Zveçan në veri të Kosovës, disa zona rurale janë shkyçur tërësisht nga furnizimi me ujë me muaj të tërë.

<sup>11</sup> Vlerësimet e komunave kryesisht bazohen në përvojën e kaluar, lokacionin gjeografik të komunës dhe nivelet aktuale të rezervuarëve të ujit.

<sup>12</sup> Vetëm Zvečan/Zveçani, Kamenica/Kamenica dhe Malisheva/Mališevo mendojnë se gjendja e tyre është më e keqja në rajonin e tyre.

mungesave të ujit në të kaluarën dhe atyre në të ardhmen. Megjithatë, vetëm 25% e tyre kanë plan emergjent për kohët e ndërprerjeve akute, duke u mbështetur kryesisht në rezervuare të lëvizshme dhe në mirëmbajtjen më të mirë të gypave.<sup>13</sup>

Në viset malore, fshatrat shpesh kanë qasje në burime të ndryshme të ujit malor, por ato zakonisht më shumë varen nga rryma elektrike për shkak të shtypjes së ulët të ujit. Në përgjithësi, rajonet rurale kanë më pak qasje në ujë sesa ato urbane. Andaj, në kohërat e reduktimeve të zgjatura të ujit shumë fshatra rurale mund të drejtohen puseve të tyre të ujit dhe burimeve natyrore të ujit, edhe pse ato shpesh janë të kontaminuara. Një problem tjetër në tërë Kosovën janë edhe gypat që e rrjedhin ujin. Valvulet vidhen rregullisht dhe gypat shpesh nuk mirëmbahen mirë për arsye financiare.

Shumica e komunave të Kosovës që kanë vuajtur nga reduktimet e ujit kanë miratuar akte ligjore komunale me qëllim të rregullimit të shfrytëzimit të ujit, p.sh. ndalimi i aktiviteteve siç janë larja e automjeteve, larja e rrugëve dhe harxhimi i ujit për ujitje të kopshteve. Këto ndalesa më së shumti janë të lidhura me sanksionimet për sjelljet e këqija. Sidoqoftë, këto masa vështirë se janë implementuar dhe zbatuar plotësisht. Vetëm në disa raste, inspektorët i kanë çkyqur konsumatorët nga rrjeti i ujësjellësit pasi që ata ua kanë lëshuar vërejtjet me shkrim. Masat e tjera që janë ndërmarrë janë takimet publike me banorët për të diskutuar për çështjen e reduktimeve të ujit, duke bërë aktivitete të vetëdijesimit për shfrytëzim racional të ujit (për shembull, nëpër shkolla dhe nëpërmjet mediave), ruajtjen e valvuleve të sistemit të gypave të ujësjellësit për të parandaluar lidhjen e paligjshme nëpër to, si dhe për ndërtimin e më shumë cisternave dhe puseve nëpër zonat e prekura. Po ashtu, pak janë rritur edhe investimet nga komunat (servisimi i pompave dhe i gypave, trajtimi i ujit të pijshëm, etj.).

Zyrtarët komunalë nuk i perceptojnë si problem politik reduktimet e rrymës dhe problemet e ngjashme si të motivuara etnikisht (pompas të ujit funksionojnë me rrymë elektrike). Vetëm në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica priten vështirësi sa i përket mospagesës së faturave të ujit nga serbët e Kosovës.

## 4. Korniza ligjore

### 4.1 Kompetencat për menaxhimin e ujit

Mbrojtja e burimeve të ujit dhe menaxhimi i furnizimit me ujë rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/41.<sup>14</sup> Sipas kësaj Rregulloreje, autoritetet kompetente për menaxhimin e ujërave në Kosovë janë këta: Qeveria, Autoriteti për Ujë i Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor<sup>15</sup>, Autoritetet Rajonale për Pëllgjet Ujore dhe Komunitet.<sup>16</sup> Neni 20 i Ligjit për Ujë të Kosovës parasheh që komuna i administron burimet e furnizimit me ujë në nivelin lokal, si dhe burimet natyrore të ujit, burimet publike, pusët publike dhe kanalet.

<sup>13</sup> Vetëm Prishtina/Priština, Leposavić/Leposaviqi dhe Zubin Potoku/Zubin Potok rregullisht i shqyrtojnë planet e tyre emergjente.

<sup>14</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/41 mbi shpalljen e Ligjit për Ujërat e Kosovës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji për Ujërat e Kosovës).

<sup>15</sup> Sipas nenit 18 të Ligjit për Ujërat e Kosovës, përgjegjësitë e Ministrisë janë si në vijim: “a) përcaktimin dhe implementimin e politikave zhvillimore për ujërat në Kosovë, si dhe realizimin e objektivave të aprovuara nga programi i Qeverisë; b) menaxhimi i resurseve ujore; c) hartimin e planit strategjik të ujërave dhe planeve të tjera për administrim të ujërave, të cilët dalin nga ky ligj; dhe d) kryerjen e detyrave menaxheriale dhe profesionale të lidhura me to, si dhe detyrat e tjera organizative zhvillimore sipas dispozitave të këtij ligji.” Ministria gjithashtu ka nxjerrë një numër udhëzimesh në lidhje me ujin (shih shtojcën).

<sup>16</sup> Ligji për Ujërat e Kosovës, neni 16; Autoriteti i Ujërave në Kosovë dhe Autoritetet rajonale të baseneve të lumenjve nuk ekzistojnë më.

Komunat mund t'i bartin autorizimet e tyre të furnizimit me ujë të kompanitë rajonale të ujësjellësit nëpërmjet kontratave të nënshkruara. Marrëveshjet e tilla për shërbime përfshijnë një spektër të gjerë të drejtave dhe të obligimeve, për shembull, detyrat e kompanive të ujësjellësit për të "operuar me sistemin në mënyrë efikase dhe efektive dhe që të përmbushin objektivat e përmirësuar të performancës të parashtruara nga Bordi i Drejtorëve"<sup>17</sup>. Përparësitë e marrëveshjeve të tilla janë shpesh që kompanitë rajonale të ujësjellësit kanë njohuri dhe pajisje më të mirë për të siguruar mirëmbajtje të vazhdueshme.

#### 4.2 E ardhmja e menaxhimit të furnizimit me ujë në Kosovë

Në qershor të vitit 2008, Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, i cili ka menaxhuar kompanitë rajonale të ujësjellësit, i mbylli operacionet e saja pa transferuar zyrtarisht përgjegjësitë te ndonjë autoritet tjetër. Kuvendi Kosovës miratoi legjislacionin për marrjen e përgjegjësisë për kompanitë publike nga AKM-ja, përfshirë këtu kompanitë e ujësjellësit. Pritet që legjislacioni shtesë do t'u jep komunave pronësinë në formën e përgjegjësisë të aksionarëve për kompanitë aksionare të ujësjellësit. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës ka parasysh krijimin e një organizatë pasardhëse të AKM-së, e cila do të jetë nën mbikëqyrjen e Qeverisë.

Sidoqoftë, mbetet të shihet se çfarë ndikimi do të ketë mbyllja e AKM-së, d.m.th. tërheqja e institucionit të vetëm rregullator ndërkombëtar që mbikëqyr sektorin e ujërave në Kosovë, në nivelin e funksionimit dhe të profesionalizmit të menaxhimit rajonal të ujërave pas qershorit të vitit 2008. Zbrazëtira politike pas qershorit të vitit 2008 mund të ketë ndikime negative në funksionimin e sektorit të ujërave. Duhet të mënjanohen faktorët siç janë ndikimi dhe qëndrimi politik, për shembull plotësimi i posteve sipas përcaktimeve politike, e jo atyre profesionale të kandidatëve. Organizatat ndërkombëtare të donatorëve që mbështesin sektorin e ujërave, mund të kenë ndonjë ndikim në këtë aspekt, pasi që me siguri investimet do të shmangen nëse zvogëlohet niveli i profesionalizmit dhe i transparencës. Kështu që, është në interes të Qeverisë së Kosovës të sigurojë që ndikimi politik në këtë sektor të jetë i kufizuar në minimum në mënyrë që të joshen donatorët ndërkombëtarë.

### 5. Vlerësimi i rrezikut

Në publikimin më të ri të gazetës *The Economist*, autori i artikullit për lumenj dhe konflikte thotë se "thatësia, shkretimi i tokës dhe mungesa e ushqimit janë ndër faktorët që ndezin konfliktet brenda shteteve duke i shndërruar disa rajone së paku në kolaps social."<sup>18</sup> Askush nuk mund t'i mohojë kërcënimet e ndryshme ndaj qëndrueshmërisë së furnizimit me ujë në Kosovë në të ardhmen. Në këtë aspekt, për vlerësimin e rrezikut duhet pasur parasysh një sërë dimensionesh. Këto dimensionesh shpesh ndërliken në mes vete dhe kështu mund të shprijnë në "efektet domino".

#### 5.1 Kërkesa më e lartë

Posaçërisht në rajonin e Prishtinës/Priştina numri i madh i shfrytëzuesve të ri shton një ngarkesë shtesë në sistemin ekzistues të furnizimit me ujë.<sup>19</sup> Vlerësimi i përafërt i popullatës së përgjithshme të Prishtinës/Priştina ndryshon në mënyrë të konsiderueshme, prej 300,000 deri në 500,000 banorë që aktualisht jetojnë në komunë. Kjo pasqyron rritjen drastike të konsumatorëve të ujit nga vitet e

<sup>17</sup> Fragment nga marrëveshja për shërbim ndërmjet komunës dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit. Këto marrëveshje "nuk mund të modifikohen përveç se me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët dhe AKM-ja".

<sup>18</sup> *The Economist*, rrjedhat e gjakut, ose burimet e paqes (*Streams of blood, or screams of peace*), Volume 387, Numër 8578, 3 - 9 maj 2008, faqe 66.

<sup>19</sup> Sipas një përfaqësuesi të një kompanie të ujësjellësit në Prishtinë/Priştina, ekzistojnë më se 300 konsumatorë të ri në baza mujore në rajonet e tyre të përgjegjësisë dhe se faturat e konsumatorëve në rajon gati sa është dyfishuar që nga viti 1999.

tetëdhjeta kur popullata e Prishtinës/Priştina ka qenë e ulët, 70,000 banorë.<sup>20</sup> Për arsye financiare nuk është e qartë se a mund të lidhen shumë blloqe të ndërtesave në këtë rajon në sistemin e ujësjellësit. Kjo gjithashtu është për arsye që dy fabrikat kryesore të furnizimit me ujë nuk mund të sigurojnë më shumë ujë të pijshëm. Ngjashëm, rajonet tjera nuk do të mund të përballojnë më shumë konsumatorë.<sup>21</sup>

Reduktimet e rënda të ujit mund të ndikojnë te konsumatorët individual, e po ashtu edhe sektorin bujqësor dhe industrial të Kosovës (apo në të gjithë këta) gjë që përfundimisht do të mund të kishte pasoja në furnizimin me mallra dhe shërbime të rëndësishme. Pavarësisht nga zgjerimi, duket se rajonet rurale dhe rrethinat më shumë preken me reduktimet e ujit në krahasim me rajonet tjera.

## 5.2 Faktorët e mjedisit

Problemet e furnizimit me ujë në Kosovë nuk kanë të bëjnë vetëm me furnizimin dhe qasjen në ujë, por edhe me qasjen në ujë të sigurt. Sipas Këshillit Botëror të Ujit, “për arsye të mungesës së sistemeve adekuate sanitare, më se 80% të popullatës rurale në Kosovë e konsumojnë ujin e kontaminuar nga pusët vetanake”.<sup>22</sup> Ekzistojnë rreziqe të ndryshme për furnizim me ujë dhe të cilësisë së ujit (burimor), varësisht nga rajoni dhe burimet përkatëse të ujit. Rreziqet kryesore të identifikuara të mjedisit janë ndotja e baseneve të ujit, lumenjve, ujit nëntokësor dhe puseve.

- **Ndotja e baseneve të ujit:** Rezervuari i Badovcit – njëri ndër furnizuesit kryesor me ujë për rajonin e Prishtinës/Priştina – gjendet përgjatë rrugës, ku përveç komunikacionit të rëndë, kamionët që bartin mallra të rrezikshme, kalojnë me shpejtësi të madhe. Rruga kufizon liqenin në distancë prej gjashtë kilometrave, shumica e të cilave nuk është mbrojtur me masa të përshtatshme të parandalimit të automjeteve nga rënia e tyre në ujë në raste të aksidentit.<sup>23</sup>
- **Ndotja nëpërmjet gypave që rrjedhin:** ujërat nga rezervuarët ujorë mund të kontaminohen nëpërmjet sistemit të vjetër të tubacioneve dhe gypave që disa kanë rrjedhje. Fakti që gypat për ujë të pijshëm dhe gypat e ujërave të zeza shpesh ndodhen pranë njëra tjetrës shton një rrezik tjetër, që mund të rrezikojnë shëndetin e një pjese të popullatës.
- **Ndotja e lumenjve dhe ujërave nëntokësore:** ujërat e zeza nga amvisëritë dhe fabrikat në Kosovë nuk trajtohen fare dhe derdhen drejtpërdrejt në lumenj dhe fusha. Kjo rezulton me atë që shumë lumenj në Kosovë janë mjaft të ndotur dhe gjithashtu paraqet kërcënim për ujërat nëntokësore në afatin e gjatë. Në fakt, monitorimet aktuale kimike dhe bakteriologjike tregojnë që shumica e lumenjve në Kosovë janë të ndotur dhe nuk mund të shfrytëzohen para se të bëhet pastrimi paraprak i ujit. Përderisa shumë lumenj në burim kanë cilësi të mirë, kjo shpejt ndryshon pasi që lumenjtë kalojnë nëpër qyteza dhe pjesët industriale.<sup>24</sup>
- **Ndotja e puseve:** në veçanti në rajonet rurale, shumë njerëz varen nga uji i puseve individuale.<sup>25</sup> Andaj, shumë nga këto puse janë të ndotura shumë dhe paraqesin rrezik për shëndetin e popullatës. Pa ndonjë alternativë tjetër, popullata do të vazhdojnë ta shfrytëzojnë

<sup>20</sup> Kompania e ujësjellësit Prishtina, studim i fizibilitetit, përmbledhje e raportit, 2002.

<sup>21</sup> Drejtori i Kompanisë së Ujësjellësit Prishtina i referohet Prishtinës/Priştina, Gjilanit/Gnjilane, dhe Ferizajt/Uroševac; përderisa Peja/Peć, Prizreni dhe Mitrovicë/Mitrovica gëzojnë kushte më të mira.

<sup>22</sup> Këshilli Botëror për Ujë, *E drejta për ujë në Kosovë*, në: Lajmet e reja nr. 22 shkurt 2007, faqe 4.

<sup>23</sup> Rezervuarët Badovc dhe Batllava mbulojnë me ujë më se 90% të rajonit. Uji nga Badovci pastrohet nëpërmjet një fabrike për pastrim të ndërtuar në vitet e gjashtëdhjeta. Uji nga Batllava pastrohet nëpërmjet një fabrike për pastrim të quajtur Albanik, të ndërtuar në vitet e tetëdhjeta dhe i cili ruhet nga KFOR-i. Dhjetë përqindëshi tjetër furnizohet nëpërmjet rezervuarëve më të vegjël në rajon, të furnizuar nëpërmjet ujërave nëntokësore.

<sup>24</sup> UNMIK/Institucionet e Përkohshme për Vetëqeverisje, *Raporti për gjendjen mjedisore në Kosovë*, 2003, faqe 18; në fshatin Llaplasellë/Laplje Selo, pjesë e komunës së Prishtinës/Priştina, lumi është jashtëzakonisht i ndotur nga mbeturinat dhe nga ujërat e zeza. Në verë, prijësit e fshatit ankohen për erë shumë të papërbalueshme në veçanti që del nga kanalizimi dhe kërcënohet shëndeti i popullatës.

<sup>25</sup> Sipas një vlerësimi të një përfaqësuesi të Kompanisë së Ujësjellësit të Prishtina, më se 10% e popullatës në rajonin ku e mbulon kompania me përgjegjësi nuk është e kështu në rrjetin e përgjithshëm të tubacionit.



ujin nga këto puse. Kështu, është shumë me rëndësi që të lidhen fshatrat e rrethit në sistemin e funksional të ujësjellësit.<sup>26</sup>

### 5.3 Kufizimet financiare

Rrjedhjet në gypa, kyçjet e paligjshme, si dhe mospagesa e faturave të ujit paraqesin arsyt kryesore për humbjet e ujit në gjithë Kosovën, në kuptimin material dhe atë financiar. Sipas përfaqësuesit të Kompanisë së ujësjellësit Prishtinë/Priština, vetëm 62% e konsumatorëve paguajnë faturat e tyre të ujit. Përveç kësaj, ekziston një humbje e madhe e ujit nga rrjedhjet e gypave dhe kyçjet ilegale. Të ardhurat e humbura do të ishin të nevojshme për:

- Mirëmbajtjen e sistemit ekzistues të tubacioneve dhe kyçjen e klientëve të rinj;
- Mirëmbajtjen dhe renovimin e pjesshëm të centraleve të trajtimit të ujit;
- Angazhimin në projekte trans-rajonale për të gjetur zgjidhjet afatgjate për furnizim të qëndrueshëm të ujit për gjitha rajonet në Kosovë, për shembull përmes ndërtimit të pendave për të ruajtur ujin dhe shtrimin e gypave për transportimin e këtij uji nga rajonet e pasura me ujë tek rajonet e varfra me ujë;
- Angazhimin në fushata të vetëdijesimit mjedisor;
- Hartimin e projekteve për përpunimin e ujërave të zeza për të shmangur kontaminimin e lumenjve dhe puseve.

### 5.4 Rreziku i reaksionit zinxhiror

Termocentrali Kosova B i Korporatës Energjetike të Kosovës në Obiliq/Obilić ka nevojë për një sasi të madhe të ujit për ftohje, e cila aktualisht sigurohet nga rezervuari i Gazivodës për të qenë funksional. Një çrregullim i mundshëm i furnizimit të ujit nga Gazivoda do të mund të krijonte një reaksion zinxhiror. Kjo ndodh për faktin se shumë stacione pompimi të ujit varen nga furnizimi elektrik. Reduktimet elektrike, të cilat shkaktohen nga mungesa e ujit për ftohje kështu do të mund të shkaktonin më shumë reduktime të ujit, të cilat do të shkaktoheshin nga pompat jo-funksionale.

### 5.5 Rreziqet politike

Rezervuari i Gazivodës në Zubin Potok në Kosovën veriore është një nga rezervuarët më të mëdhenj të ujit të llojit të vet në Evropë dhe është një nga asetet më të rëndësishme për ekonominë e Kosovës.<sup>27</sup> Ai siguron ujin për ftohjen e Termocentralit të KEK-ut, Kosova B, në Obiliq/Obilić dhe në të kaluarën ka pasur rëndësi jetike për Ferronikelin dhe minierat e Trepçës. Për më tepër, ai furnizon sipërfaqen mes Mitrovicës/Mitrovica dhe Prishtinës/Priština me ujë për ujitje dhe pije, si dhe përbën rezervuarin emergjent për ujë të pijes për qytetin e Prishtinës/Priština.

Derisa rezervuari i Gazivodës është i vendosur në një zonë të banuar me serbë<sup>28</sup>, uji përpunohet në një zonë të banuar me shqiptarë.<sup>29</sup> Kështu, bashkëpunimi mes personelit shqiptar dhe personelit serb përgjegjës për furnizimin e ujit ka rëndësi qenësore. Edhe pse koordinimi duket të jetë funksional në

<sup>26</sup> Kačanik/Kaçanik, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Shtime/Štimlje, Suharekë/Suva Reka, Klinë/Klina, Obiliq/Obilić, dhe Gjakova/Đakovica janë të varura shumë nga burimet nëntokësore siç janë puset individuale dhe burimet e ujit.

<sup>27</sup> Sistemi i furnizimit të ujit është ndërtuar në vitet 1980/84, financiar nga Banka Botërore dhe me vetë-kontributin e banorëve të Zvečan/Zvečanit dhe Mitrovicës/Mitrovica.

<sup>28</sup> Me 15% të rezervuarit që i përket Serbisë.

<sup>29</sup> Uji i rezervuarit të Gazivodës përpunohet në “Fabrikën e Ujit” të vendosur në fshatin Sipolje/Shipol, në jug të Mitrovicës/Mitrovica, dhe tutje shpërndahet përmes një gypi që kalon nën urën kryesore. Sistemi i ujit që lidh rezervuarin e Gazivodës me “Fabrikën e Ujit” operohet nga kompania “Javno Preduzeće ‘Ibar’” e cila menaxhohet dhe financohet nga Beogradi.

sipërfaqe, ekziston një mungesë e bashkëpunimit të vërtetë të aktorëve të përfshirë në çështjet e furnizimit të ujit.<sup>30</sup>

Ekziston rreziku që raportet në mes komuniteteve në veri dhe jug të përkeqësohen në të ardhmen, pasi serbët që jetojnë në veri të lumit Ibër thonë që diskriminohen në lidhje me furnizimin e ujit. Ky perceptim del pjesërisht nga fakti që pasi uji përpunohet në jug, gypat e ujit të freskët së pari kalojnë përmes jugut të Mitrovicës/Mitrovica para se të arrijnë tek serbët e Kosovës në Zvečan/Zveçan dhe në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Kështu, shumica e ujit konsumohet në jug, duke e lënë veriun me furnizim të pamjaftueshëm të ujit, gjë që ka çuar në mungesa serioze të ujit në tetë vitet e fundit.<sup>31</sup> Ky diskriminim i perceptuar etnik në të ardhmen mund të shkaktojë konflikte, sidomos nëse kërkesa për ujë vazhdon të rritet në jug, gjë që do të çonte në sasi edhe më të vogla për pjesët e largëta përfshirë veriun. Kështu, sistemi i furnizimit të ujit duhet të përshtatet për nevojat e gjithë konsumatorëve.

OSBE-ja ishte informuar më 9 korrik 2008 që një kompani lokale e furnizimit të ujit kishte filluar ndërtimin e një sistemi të ri gypash për të përmirësuar furnizimin e ujit për rreth 1,000 banorë të veriut të Mitrovicës/Mitrovica. Projekti do të financohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe do të implementohet bashkë me UNMIK-un.

## 6. Rëndësia e bashkëpunimit rajonal dhe ndërshtetëror

Ekzistojnë tre pellgje lumore që dalin jashtë Kosovës që derdhen në tri dete të ndryshme (Detin e Zi, Detin Egje, Detin Adriatik, shih tabelën e mëposhtme), gjë që është situatë mjaft e veçantë. Ibrë është i vetmi burim madhor i ujit që rrjedh në Kosovë.

**Tabela: Pellgjet lumore në Kosovë**

Pellgu lumor	Zona e akumulimit	Sipërfaqja (Km <sup>2</sup> )	Vëllimi mesatar (m <sup>3</sup> /s)
1. "Drini i Bardhë"	Adriatik (përmes Shqipërisë)	4400	60
2. "Ibër"	Deti i Zi (përmes Danubit)	4700	33
3. "Morava e Binçes"	Deti Egje (përmes Vardarit)	1600	7
4. "Lepenci"	Deti Egje (përmes Vardarit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë)	800	8

Burimi: Baza e të dhënave të hidro-ekonomisë për Kosovën, 1983 Beograd

Aspektet ndërshtetërore të lumenjve zakonisht çojnë drejt një niveli të caktuar të mekanizmit të bashkëpunimit rajonal për të shmangur konfliktet e mundshme që dalin nga shfrytëzimi dhe menaxhimi i ujit në rrjedhën e poshtme, p.sh. ndotjen apo ndërtimin e pendëve. Në këtë kuptim, shpesh vendosen mekanizma të arbitrazhit rajonal apo bilateral apo të përputhshmërisë. Sa i përket

<sup>30</sup> As komuna e Zveçanit e as Mitrovica/Mitrovica veriore, e as Kompania e Ujit "Ibar" s'kanë qasje në "Fabrikën e Ujit" në jug. I vetmi bashkëpunim në lidhje me furnizimin e ujit ekziston me komunën e Zubin Potokut, ku është i vendosur rezervuari i Gazivodës. Niveli i lumit Ibër rregullohet me një pendë hidrocentrale në rezervuarin e Gazivodës. Më 2006 ishte themeluar një Grup Punues Rajonal me qëllim të bashkërendimit të veprimtarive mes aktorëve kryesorë të përfshirë në furnizimin e ujit në jug dhe veri. Megjithatë, ky Grup Punues dështoi në trajtimin e këtyre çështjeve pasi problemi ishte politizuar. Përfaqësuesit serbë dolën nga Grupi Punues më 2007.

<sup>31</sup> Kapacitetet e ndërtuara të sistemit të furnizimit të ujit fillimisht ishin menduar për të mbuluar nevojat e vetëm dy komunave: Zubin Potok dhe Mitrovicës/Mitrovica. Në periudhën mes 1984 dhe 1999, komunat tjera ishin lidhur në rrjet, gjë që kishte shkakuar furnizimet e dobëta të disa pjesëve rurale në rajon. Gjendja e furnizimit të ujit u rëndua edhe më shumë nga koncentrimi i njerëzve në sipërfaqen urbane të Mitrovicës/Mitrovica së jugut. Kështu, sasia e ujit që arrin në Zvečan/Zveçan dhe Mitrovicën/Mitrovica veriore është e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat e popullsisë aktuale në veri, e cila është rritur për rreth 11,000 persona të zhvendosur. Një faktor tjetër që shkakton furnizimin e dobët të ujit është fakti që Zvečan/Zveçani dhe Mitrovica e veriut gjeografikisht janë në pozitë më të lartë në krahasim me komunat tjera në rajon. Përveç këtij, ka humbje në tubacione për shkak të infrastrukturës së vjetruar, si dhe harxhimeve irracionale të qytetarëve. Për shkak të këtyre problemeve, verën e kaluar zonave rurale të Zvečan/Zveçanit iu ishte ndërprerë furnizimi për muaj të tërë.

lumenjve që burojnë në Kosovë, nuk ekzistojnë mekanizma të tillë. Në të ardhmen, mënyra të tilla të rregullimit të menaxhimit ndër-kufitar të rrjedhave ujore të Drinit të Bardhë/Beli Drin që rrjedhin nga Kosova në Shqipëri, mund të fitojnë në rëndësi, duke marrë parasysh shkallën e lartë të ndotjes së lumenjve në Kosovë. E njëjta vlen edhe për lumin Sitnicë i cili është shumë i ndotur me mbeturina industriale dhe derdhet në lumin Ibër.

## 7. Përfundimet dhe rekomandimet

Në bazë të rezultateve të hulumtimit mund të nxjerrën përfundimet në vijim:

- OSBE-ja nuk është në dijeni të ndonjë diskriminimi sistematik apo të ndonjë rasti serioz të trajtimit selektiv në lidhje me shpërndarjen e ujit apo reduktimeve të ujit në Kosovë. Megjithatë, kontestet në lidhje me furnizimin e ujit në të ardhmen mund të çojnë në trajtim preferencial nëse burimet janë më të pakta.
- Ekzistojnë rreziqe qenësore mbi furnizimin e ujit në Kosovë, duke supozuar që në të ardhmen e afërt furnizimi i ujit do të mbetet i njëjtë apo do të përmirësohet pak, por jo mjaftueshëm. Fshatrat e largëta dhe të vogla janë më të prekurat nga reduktimet e ujit.
- Niveli i vetëdijes së komunave dhe qeverisë mbi problemet me furnizimin dhe cilësinë e ujit duket të jetë i ultë në gjitha komunat, gjë që gjithashtu është rezultat i ndarjes së kompetencave tek kompanitë rajonale të ujit. Mungesa e vetëdijes është arsyeja kryesore pse masat në lidhje me reduktimet e ujit janë implementuar dhe zbatuar në mënyrë jo-efektive.
- Mungesa totale e trajtimit të ujërave të zeza në Kosovë paraqet një rrezik për ujërat nëntokësorë dhe të pijes, si dhe për natyrën në përgjithësi. Disa forma të mbeturinave industriale mund të shkaktojnë dëme afatgjate në mjedis.
- Për shkak të rritjes së popullsisë në Kosovë, si dhe numrit në rritje të amvisërive të kyçura në sistemet ujore, kërkesa për ujë do të rritet shumë në muajt dhe vitet në vijim.
- Sistemet e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza në Kosovë vuajnë nga dështime serioze të pajisjeve dhe problemeve të mirëmbajtjes, të cilat kanë nevojë të madhe për investime të konsiderueshme në infrastrukturën ujore. Investimet e domosdoshme zvogëlohen edhe më shumë nga fakti që një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve nuk paguan faturat e ujit.
- Pas mbylljes së Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, ekziston rreziku i një vakumi politik që prekë menaxhimin e furnizimit të ujit dhe cilësisë së tij në Kosovë.
- Natyra e shumëfishtë dhe dimensionit i ndërlidhur i resursit ujë (p.sh. implikimet politike, socio-ekonomike, financiare, ekologjike) mund të krijojnë një efekt domino, që ka mundësi të përkeqësojë krizën e ujit.

Është e paqartë nëse institucionet e Kosovës, pa mbështetjen financiare të komunitetit ndërkombëtar të donatorëve, do të jenë në gjendje të përballen me mungesat e ardhshme të ujit, meqë ato qysh tani mbështeten në masë të madhe nga ndihma e aktorëve ndërkombëtarë si KFOR-i.

Për shkak të këtyre aspekteve negative në lidhje me qasjen në ujë, OSBE-ja rekomandon që autoritetet qendrore dhe lokale të angazhohen në trajtimin e kësaj çështjeje si në afat të shkurtër ashtu në atë të gjatë, në mënyrat si në vijim:

- **Në kuptimin afatshkurtër:**
  - Të vlerësohen nevojat për investime në infrastrukturën e re të ujit (duke përfshirë trajtimin e ujërave të zeza) dhe për riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese për t'i paraqitur tek donatorët e mundshëm vendorë e ndërkombëtarë sa më shpejt që është e mundur.
  - Të trajtohen menjëherë disa rreziqe të identifikuara, p.sh. përmes masave speciale të sigurisë për rrugën përgjatë rezervuarit të Badovcit.
  - Të hartohen plane emergjente bashkë me secilën komunë individualisht.

- Secila komunë ka nevojë për një linjë të qartë të përgjegjësi në lidhje me çështjet lokale të ujërave.
  - Angazhimi i menjëhershëm në fushatat e vetëdijesimit dhe edukimit të njerëzve për të qenë më të përgjegjshëm me resurset ujore, p.sh. përmes fushatave në media dhe broshurave informative.
  - Kufizimi i shpenzimeve evidente dhe të mëdha të ujit, si shpëlarja e trotuareve e të ngjashme.
  - Trajtimi i vakumit të mundshëm politik pas mbylljes së veprimtarisë së Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në qershor të vitit 2008. Transparenca dhe profesionalizmi duhet të jenë çelësi i punësimeve në sektorin e ujit.
- **Afatgjatë:**
    - Trajtimi i rreziqeve të identifikuara përmes planeve afatgjate, p.sh. vendosja e masave për kursimin e ujit, ndërtimi i kanaleve të reja rajonale, si dhe mirëmbajtja e zgjerimi i sistemit.
    - Kyçja e fshatrave të largëta me sistemin e furnizimit të ujit për të shmangur varësinë e popullsisë rurale tek uji i ndotur i puseve lokale.
    - Hartimi i një strategjie afatgjate të ujit në bashkëpunim mes nivelit qendror dhe komunave.
    - Rritja e bashkëpunimit dhe informimit mes administratës komunale dhe nivelit rajonal e atij qendror.
    - Sigurimi i zbatimit të ligjit kundër kyçjeve të paligjshme dhe borxheve të konsumatorëve.
    - Parandalimi i diskriminimit të mundshëm të komuniteteve në lidhje me kufizimin e shfrytëzimit të ujit.